



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 293/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër Fatmir Behlulit nga fshati Serbicë e Poshtme komuna e Prizrenit për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega Prizren në të cilën theksohet se me datën 08.06.2014 rreth orës 11:30, në Serbice të Poshtme të komunës së Prizrenit në vendvotimin 2012a/01r, personi me emrin Besim Gjelaç, ka hyrë dy herë radhazi në vendvotim dhe ka asistuar për nënën dhe gruan e tij duke bërë shkelje të nenit 89, paragrafi 5, të ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme. Ky veprim i paligjshëm sipas ankuesit është tentuar të pengohet nga komisionari i Lëvizjes Vetëvendosje Fatmir Behluli mirëpo nuk ka qene e mundur dhe të njëjtin rast e ka shënuar në librin e shënimeve në orën 11:37. Këto veprime sipas parashtresës të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregullat Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të LVV-së janë të pabazuara pasi që ankesës në fjale nuk i ka bashkangjitur asnjë prove shtesë me të cilën mund të vërtetohen shkeljet e supozuara nga personi në fjalë. Andaj PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i pabazuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 3.6 pika b) Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 293/2014 më datën 11.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

